

«ACCOMPAGNA»

Rritja e mundësive arsimore për fëmijët e sapoimigruar

Fëmijët e sapoimigruar dhe me nevoja të veçanta arsimore do të mbështeten nga studentët e Universitetit Pedagogjik të Sankt-Galenit (PHSG).

Çfarë është «ACCOMPAGNA»?

Me projektin "ACCOMPAGNA" fëmijët e sapoimigruar përkrahen nga studentët e Universitetit Pedagogjik të Sankt-Galenit (PHSG). Për gjashtë muaj, mësuesit e ardhshëm vizitojnë fëmijët në shkollë. Një herë në javë, çdo fëmijë merr mbështetje individuale në tematikat shkollore. Projekti kontribuon në rritjen e mundësive arsimore të fëmijëve të sapoimigruar.

Cilët fëmijë mund të marrin pjesë?

Fëmijët e sapoemigruar me nevoja të veçanta arsimore që ndjekin një klasë të rregullt ose klasë integrimi në rajonin e Zvicrës Lindore mund të përfitojnë nga projekti "ACCOMPAGNA". Nevoja për përkrahje u përgjigjet rasteve të refugjatëve, ndjekjes për afat të shkurtër të shkollës, nevojës për përvetësimin e gjuhës së dytë dhe/ose mungesës së mbështetjes për çështjet shkollore në mjedisin familjar.

Çfarë do të përkrahet?

Do të...

- tregohen teknika mësimore në mënyrë që fëmija të mësojë sa më me sukses të jetë e mundur për shkollën.
- diskutohen detyrat e klasës dhe të shtëpisë.
- trajtohen pyetjet e fëmijëve nga jeta e përditshme në shkollë (p.sh. për orarin, për ndarjen e lëndëve ose notat).

Studentët marrin parasysh kërkesat e fëmijëve dhe fillojnë me nevojat e tyre. Nevoja individuale për mbështetje diskutohet me mësuesin e klasës.

Kur dhe ku zhvillohet mbështetja?

Çdo fëmijë pjesëmarrës ka të drejtë të marrë përkrahje një herë në javë. Mbështetja zhvillohet gjatë kohës së rregullt të klasës në shkollën e fëmijës. Fillimi i përkrahjes dhe datat e takimeve përcaktohen individualisht.

Studentët përgatiten dhe shoqërohen me kujdes nga PHSG për detyrën e tyre.

Sa kushton pjesëmarrja në projektin «ACCOMPAGNA»?

Nuk ka kosto për prindërit dhe shkollat. Ambientet vihen në dispozicion nga komunitetet e shkollave. Projekti "ACCOMPAGNA" financohet nga PHSG, kantoni i Sankt-Galenit (Integrationsförderkredit) dhe Fondacioni "Paul Shiler", Cyrih.

Si regjistronen fëmijët?

Pas konsultimit me administruesit e projektit, drejtuesit e shkollës ose mësuesit mund të regjistrojnë një a më shumë fëmijë për të marrë pjesë në projektin "ACCOMPAGNA". Prindërit e interesuar duhet t'i drejtohen mësuesit kujdestar së fëmijës së tyre.

Përkthimet e kësaj fletushke në gjuhë të ndryshme mund të gjenden në faqen e internetit të projektit.

Kontakt

Administruesit e projektit: Prof. Dr. Sonja Bischoff, Pädagogische Hochschule St.Gallen, ,
Notkerstrasse 27, 9000 St.Gallen, accompagna@phsg.ch, T +41 71 243 96 22

blogs.phsg.ch/accompagna/